

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Benet Beci "i bën fresk" Dulakëve me 130 milionë lekë
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1392329.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 18:39:06 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	17 shtator 2026, 18:38:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 17 shtator 2026, 18:37:00 UTC → 17 shtator 2026, 18:39:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	aeb937f77b8459aa13f3df1a5988d4a1d2e65102782e58f9e851bbd47659ffd9
TEKSTI	3a6309567bd597b98468b6e0314e2d31cd085f167d44f45f6ad34ea62bdba597
PAMJA	b2f0973b0889df49e76ec344f301369e65c42763a8ed704f9ae06da814e3c4d1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a2c04f2915135a5a2df5a5d4470132cc09b84fed56c1bb15ba7c6cb82e526796
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	902d0413a229cd6f0d4d0cd18f47f680be9b1c51dede64b7e44b0e89ca82109d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a2c04f2915135a5a2df5a5d4470132cc09b84fed56c1bb15ba7c6cb82e526796>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Benet Beci “i bën fresk” Dulakëve me 130 milionë lekë

Shkruar nga: M Gjini | Publikuar më: 17.09.2026, 20:38

Share

Share



Një tjetër procedurë prokurimi publik e fshehur pas fasadës së "gjelbërimit" dhe "mbrojtjes së mjedisit" ngre dyshime të forta për abuzim me fondet publike dhe kufizim të garës. Bëhet fjalë për një tender të zhvilluar nga Bashkia Shkodër, e cila ka mbyllur procedurën për blerjen e automjeteve elektrike, ku fituesi është shpallur në shkelje të dukshme të parimeve të konkurrencës së lirë, me një diferencë qesharake nga fondi limit.

Objekti i tenderit : Blerje automjeteve elektrike

Autoriteti kontraktues : Bashkia Shkodër

Fituesi : ALBANIA MOTOR COMPANY

Rezultati : 10,680,000.00 Lekë

NIPT : K41829010I

Procedura : E hapur

Tipi i kontratës : Mallra

Numri i referencës : REF-96915-08-21-2026

Numri i Njoftimit : CN/64999/09162026

Fondi limit : 11,000,000.00 Lekë

Data e publikimit : 17-09-2026 Ora : 14:33

Data e hapjes : 24-08-2026 Ora : 10:00

Data e mbylljes : 09-09-2026 Ora : 10:00

Pezulluar : Jo

Kodi CPV : 34144900-7 - Automjete elektrike,

Detajet e Procedurës:

- Autoriteti Kontraktues: Bashkia Shkodër (Kryetar: Benet Beci)
- Objekti i tenderit: Blerje automjeteve elektrike
- Fondi limit: 11,000,000 Lekë të reja pa TVSH



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

- Numri i referencës / Njohuria: REF-96915-08-21-2026 / CN/64999/09162026

- Data e shpalljes së fituesit: 17 Shtator 2026

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1- Operatori ekonomik **ALBANIA MOTOR COMPANY - K41829010I**. Me vlerë të ofertës ekonomike **10,680,000** (dhjetë milion e gjashtëqind tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Vlera OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2- Operatori ekonomik **ARTEO 2018 - L82523203F**. Me vlerë të ofertës ekonomike ekonomike **10,600,000** (dhjetë milion e gjashtëqind mijë) lekë pa tvsh.

Vlera OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Skema e fituesit dhe oferta më e ulët e skajuar

Në këtë garë, ku fondi limit ishte caktuar në vlerën 11,000,000 Lekë të reja, kanë marrë pjesë dy operatorë ekonomikë:

1. ARTEO 2018 (NIPT: L82523203F), me një ofertë ekonomike prej 10,600,000 Lekë.
2. ALBANIA MOTOR COMPANY (NIPT: K41829010I), me një ofertë ekonomike prej 10,680,000 Lekë.

Pavarësisht se kompania ARTEO 2018 paraqiti ofertën më të ulët ekonomike duke i kursyer buxhetit vendor, Bashkia Shkodër e drejtuar nga Benet Beci ka zgjedhur të shpallë fitues operatorin e dytë, ALBANIA MOTOR COMPANY, me vlerën 10,680,000 Lekë. Një diferencë minimale prej vetëm 0.7% nga fondi limit, duke ngritur pikëpyetje se përse është eliminuar oferta më ekonomike.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik **ALBANIA MOTOR COMPANY**, me NIPT **K41829010I**, me drejtor i përgjithshëm z. Gentian Karaj me ofertën ekonomike me vlerë të ofertës ekonomike ekonomike prej **10,680,000** (dhjetë milion e gjashtëqind tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

KRYETAR

BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR

ALBAN PREKA

Lidhjet e kompanisë fituese dhe hije dyshimi mbi pronësinë

Nga verifikimi i të dhënave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), kompania fituese ALBANIA MOTOR COMPANY ka si administratorë Adrian Dulaku dhe Christos Liasi. Struktura e pronësisë së saj ndahet mes shoqërisë INER sh.p.k. (50%) dhe Grand Dalewest Limited (50%).

Nga ana tjetër, shoqëria INER sh.p.k. kontrollohet nga familja e njohur e bizneseve Dulaku (Artan Dulaku, Adrian Dulaku dhe Genci Dulaku), duke e lidhur këtë tender me emra që përfitojnë rregullisht fonde publike.

Fakti që një tender me vlera miliona lekë të taksapaguesve shkodranë jepet duke shmangur ofertën më të lirë dhe duke kapur 97% të fondit limit, përbën një tregues klasik të procedurave të paracaktuara, të cilat kërkojnë një reagim urgjent nga organet e kontrollit financiar dhe drejtësisë.

ALBANIA MOTOR COMPANY

Informacioni është i përditësuar sipas të dhënave të QKB/Rregjistër Biznesi deri në datën: 2025-12-27 14:57:49

JSON CSV

